



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve

Dhjetor 2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin “**Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet në Kosovë Dhjetor 2025**”, i cili përmban të dhëna statistikore për bizneset e regjistruara tek Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB) është pjesë e ASK-së i cili përmban informacionet themelore për të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetin ekonomik në territorin e Republikës së Kosovës dhe si i tillë shërben për statistika dhe analiza të demografisë së bizneseve, përgatitjen e mostrave dhe ngritjen e rezultateve në nivel vendi për të gjitha anketat që realizohen me bizneset. RSB po ashtu shërben si burim i rëndësishëm i informacioneve për llogaritjen e Bruto Produktit Vendor.

RSB është ndërtuar dhe azhurnohet në vazhdimësi duke u bazuar në dy burime administrative të të dhënave. Nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës - ARBK dhe Administrata Tatimore e Kosovës - ATK, si dhe hulumtimet e rregullta statistikore që kryhen nga ana e ASK-së.

Kërkesa të vazhdueshme për të dhëna statistikore për ndërmarrjet vijnë çdo ditë nga shfrytëzues të ndryshëm qoftë ata të brendshëm apo ata jashtë ASK-së, prandaj duke u bazuar në këto kërkesa kemi përgatitur të dhëna të ndryshme tabelore dhe grafike.

Besojmë se ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së, dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Komentet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato mund të dërgohen në adresën elektronike: infoask@rks-gov.net

Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet në Kosovë është publikim i rregullt mujor.

Publikimin e përgatitën:

Bekim Canolli	-	Drejtor i departamentit
Burim Limolli	-	Shef i sektorit
Guxim Neziri	-	Administrator i lartë i bazave së të dhënave

Janar, 2026

Drejtor Ekzekutiv i ASK-së,
Avni Kastrati

Lista e Dhjetoresave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
RSB	-	Regjistri Statistikor i Bizneseve
ARBK	-	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
MTI	-	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
BPV	-	Bruto Produkti Vendor (GDP)
AKP	-	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
KE	-	Komisioni Evropian
NVE	-	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike
NACE Rev. 2	-	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike të KE - Versioni 2-të
NVM	-	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

Simbolet

- Nuk ka dukuri

: Mungojnë të dhënat

1 Karakteristikat e ndërmarrjeve të regjistruara në Dhjetor 2025

Në muajin Dhjetor 2025 gjithsej janë regjistruar 1 000 ndërmarrje.

Në Dhjetor 2025 krahasuar me muajin paraprak, kemi ngritje për 8.8 % të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, kemi ngritje për 6% të ndërmarrjeve të regjistruara.

Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij muaji ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 252 (25.2%), Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 120 (12%), Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 110 (11%), Prodhim me 99 (9.9%) etj.

Në kategorinë “Mikro Ndërmarrje” (0 deri në 9 të punësuar) janë gjithsej 988 ndërmarrje të regjistruara, në kategorinë “Ndërmarrje të Vogla” (10 deri 49 të punësuar) janë gjithsej 12 ndërmarrje të regjistruara, kurse në kategorinë “Ndërmarrje të Mesme” (50 deri 249 të punësuar) dhe “Ndërmarrje të Mëdha” (250+), nuk kemi ndërmarrje të regjistruara këtë muaj.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të regjioneve:

Regjioni i Prishtinës prinë me 500 ndërmarrje të regjistruara (50%),

Regjioni i Prizrenit me 105 (10.5%),

Regjioni i Gjiçanit me 99 (9.9%),

Regjioni i Ferizajt me 87 (8.7%),

Regjioni i Mitrovicës me 85 (8.5%),

Regjioni i Gjakovës me 65 (6.5%),

dhe Regjioni i Pejës me 59 (5.9%).

2 Shpjegimet metodologjike dhe përkufizime

Regjistri Statistikor i Bizneseve shërben për qëllime statistikore dhe duhet të identifikojë qartësisht njësitë, në mënyrë që:

- Të mundësojë marrjen e informacionit për to nëpërmjet burimeve administrative.
- Të mundësojë përgatitjen e mostrave; koordinimin e anketave dhe ngritjen e rezultateve të tyre në nivel vendi;
- Të mundësojë analizën demografike të ndërmarrjeve dhe njësive lidhur me to.
- Të ofroj të dhënat hyrëse (ang. input) për llogaritjen e Bruto Produktit Vendor-BPV (GDP).

Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB) - Përmban të gjitha njësitë legale (bizneset apo ndërmarrjet) që ushtrojnë aktivitetin ekonomik brenda territorit të Kosovës.

Nuk përmban: Administratën Publike, Organizatat Jo Fitimprurëse, Organizatat Ndërkombëtare.

Burimet për azhurnimin e variablave të RSB-së janë:

- Administrative
 - Informacionet nga Agjencia i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
 - Informacionet nga Administrata Tatimore e Kosovës
- Statistikore
 - Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
 - Anketat për Statistikat Afatshkurta
 - Anketa mbi Hotelerinë
 - Mbledhja e Çmimeve të Prodhimit
 - Mbledhja e Çmimeve të Importit.

Variablat kryesore të RSB grupohen në:

- Variablat e Identifikimit
 - Numrin e Regjistrimit të Biznesit (NRB), emri, forma legale, pronësia, adresat, komunikimi (tel, faks, e-mail etj.)
- Variablat shtresore
 - Aktiviteti ekonomik kryesor (NACE Rev.2), madhësia sipas numrit të punësuarve
- Variablat demografike
 - Data e regjistrimit, data e shuarjes
- Variablat që azhurnohen janë
 - Statusi i aktivitetit (aktive ose jo-aktive),
 - Aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes,
 - Madhësia sipas të punësuarve,
 - Adresat dhe variabla të komunikimit (telefon, faks, mobil, e-mail)

2.1. Përkufizime dhe definicione

Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), është klasifikim në nivel katër shifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara në subjekte të ndryshme.

Kjo nomenklaturë është përkthim dhe përshtatje e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Komunitetit Evropian (NACE Rev.2. në Gjuhën Angleze).

Përdorimi i kësaj nomenklature është obligative që nga viti 2014 në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe bazohet në rregulloren Nr.11/2013 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Struktura e veprimtarive ekonomike NACE Rev. 2 përbëhet nga 21 seksione të cilat janë prezantuar me poshtë të emërtuar me shkronja nga A deri tek U.

A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari
B	Xehetari dhe gurëthyes
C	Prodhim
D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash
F	Ndërtimtari
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave
H	Transport dhe ruajtje
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim
J	Informacion dhe komunikim
K	Aktivitete financiare dhe sigurimit
L	Aktivitete të patundshmërisë
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse
O	Administratë publike dhe mbrojtje
P	Arsim
Q	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale
R	Art, zbavitje dhe rekreacion
S	Aktivitete të shërbimeve tjera
T	Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës
U	Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale

Klasat e veprimtarive ekonomike sipas nomenklaturës së re **NACE Rev. 2** janë gjithsej 615 sosh, të cilat janë të koduar me kodin katër shifror duke filluar nga 0111 deri tek 9900.

2.2. Forma ligjore (legale) e organizimit të bizneseve

Definicionet e aplikuara për format ligjore të ndërmarrjeve sipas Rregullores 2001/16 si dhe Ligji nr.02/L123 mbi Shoqëritë tregtare dhe aksionare, e që aplikohen me rastin e regjistrimit në ARBK janë si në vijim.

1. Biznes individual - është person i vetëm fizik i cili kryen aktivitete ekonomike për qëllim të profitit dhe i cili është i regjistruar në ARBK-ë. Në biznesin individual, pronari ka përgjegjësi të pakufizuar për të gjitha borxhet e shoqërisë. Shoqëria ka një emërtim zyrtar ose përfshin mbiemrin e ligjshëm të pronarit.

2. Ortakëri e përgjithshme - Te ortakëria e përgjithshme, të gjithë ortakët përgjigjen pa kufizim, e solidarisht për borxhet e shoqërisë. Shoqëria kolektive ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve.

3.Ortakëri e kufizuar - (Shoqëri komandite) - Në shoqëritë komandite, përveç ortakëve "të pakufizuar" (ortakët që përgjigjen pa kufizim e solidarisht për borxhet e kompanisë) marrin pjesë edhe ortakët "e kufizuar" ose ata ortakë, që përgjigjen për detyrimet e kompanisë deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

4.Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara janë ato shoqëri që janë themeluar nga një ose disa themelues, të cilët përgjigjen vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve.

5.Shoqëri aksionare - Shoqëri aksionare janë ato shoqëri, kapitali i të cilave ndahet në aksione dhe që aksionaret përgjigjen vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre. Shoqëria mund të themelohet e të ketë një ose disa aksionar.

6.Kompani e huaj - Kompania e huaj është shoqëri tregtare dhe prej momentit të regjistrimit konsiderohet si dega në Kosovë që nuk ka identitet të personit juridik. Pas regjistrimit i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e themeluara në bazë të ligjit të zbatueshëm.

7.Ndërmarrje shoqërore - Ndërmarrje shoqërore do të thotë një person juridik që shumica e aseteve dhe kapitali janë në pronësi shoqërore . Këto ndërmarrje deri në privatizim monitorohen dhe regjistrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit sipas Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

8.Ndërmarrje publike - Ndërmarrja Publike është ndërmarrje e cila kryen veprimtarinë e interesit të përgjithshëm, që është e themeluar nga shteti.

Ndërmarrja publike monitorohet nga Qeveria dhe organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare. Të gjitha interesat pronësore në një ndërmarrje publike do të përfaqësohen me aksione dhe të gjitha këto aksione duhet të jenë të regjistruara.



9.Kooperativa bujqësore - Kooperativa bujqësore është një shoqëri tregtare e krijuar nga personat fizikë apo juridik të cilët duhet të jenë të gjithë bujq që kontribuojnë me pronën e vet private në kapitalin aksionar.

10.Ndërmarrje nën juridiksion të AKP - Janë ish ndërmarrjet shoqërore të cilat tani menaxhohen dhe mbikëqyren nga AKP-ja (Agjencia Kosovare e Privatizimit).

3 Ndërmarrjet e reja dhe ato të shuara sipas muajve

Tab. 1: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas muajve dhe seksioneve të aktiviteteve ekonomik


Muajt	Gjithsej	Bujqësi, pylltari dhe peshkatar	Xehetari dhe gurëthyes	Prodhim	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	Ndërtimtari	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	Transport dhe ruajtje	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	Informacion dhe komunikim	Aktivitete financiare dhe sigurimit	Aktivitete të patundshmërisë	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social I detyrueshëm	Arsim	Shëndetësi njerëzor dhe aktivitete të punës sociale	Art, zbavitje dhe rekreacion	Aktivitete të shërbimeve tjera
		A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S
2023 Dhjetor	807	16	2	75	7	3	83	213	29	61	54	5	17	93	61	3	16	17	15	37
2023 Gjithsej	11,409	395	25	1,166	106	38	1,165	2,751	277	1,063	687	101	195	1,210	785	16	157	301	222	749
2024 Janar	998	15	1	109	-	2	132	273	30	73	76	11	16	116	64	-	13	26	9	32
2024 Shkurt	1,029	19	4	114	8	4	102	276	41	85	61	11	17	113	72	1	7	25	23	46
2024 Mars	1,222	119	3	139	10	4	130	300	48	88	77	11	10	104	57	4	8	30	29	51
2024 Prill	1,081	43	-	151	7	3	128	268	36	78	60	8	12	103	76	-	13	20	19	56
2024 Maj	930	27	1	98	7	5	118	247	24	83	43	5	8	73	80	-	9	33	9	60
2024 Qershor	804	32	1	97	5	3	83	207	21	70	51	5	9	67	46	3	4	14	32	54
2024 Korrik	1,047	66	3	116	4	3	91	235	33	101	64	8	11	99	58	2	10	24	42	77
2024 Gusht	910	22	2	132	5	3	96	187	21	70	58	8	16	116	61	1	17	22	19	54
2024 Shtator	996	38	-	105	12	3	120	234	27	84	58	4	16	98	75	1	12	33	11	65
2024 Tetor	1,123	37	2	108	6	2	111	270	35	137	67	10	27	96	73	1	16	29	29	67
2024 Nëntor	968	27	3	98	7	5	122	231	32	71	55	11	18	108	66	-	10	27	25	52
2024 Dhjetor	943	25	1	86	10	2	93	245	25	86	68	14	14	105	73	2	10	29	16	39
2024 Gjithsej	12,051	470	21	1,353	81	39	1,326	2,973	373	1,026	738	106	174	1,198	801	15	129	312	263	653
2025 Janar	959	33	2	107	7	4	118	242	29	72	59	12	11	98	61	3	16	23	20	42
2025 Shkurt	1,018	17	2	106	10	4	131	251	25	82	69	5	17	129	66	1	15	23	14	51
2025 Mars	1,038	20	1	110	8	2	122	237	36	112	64	9	18	128	72	1	15	20	20	43
2025 Prill	1,143	42	1	110	18	2	132	268	46	105	77	13	19	107	67	2	7	43	19	65
2025 Maj	1,333	36	4	170	12	3	143	321	40	129	62	17	13	161	86	-	13	28	16	79
2025 Qershor	1,151	25	-	128	12	5	99	263	30	112	89	13	16	120	82	-	16	42	27	72
2025 Korrik	1,315	87	2	157	6	-	130	287	45	133	71	10	21	127	80	2	13	33	37	74
2025 Gusht	1,068	57	3	145	11	-	114	235	31	96	66	8	20	98	59	-	9	34	18	64
2025 Shtator	1,054	49	3	95	19	3	123	255	36	87	91	14	18	80	62	5	16	25	18	55
2025 Tetor	1,125	28	4	99	9	2	133	286	41	110	84	9	23	104	76	2	11	21	18	65
2025 Nëntor	919	18	5	115	5	2	69	225	28	89	76	8	17	93	65	1	12	24	18	49
2025 Dhjetor	1,000	20	2	99	8	2	88	252	27	110	96	7	22	120	58	1	8	15	12	53
2024 Gjithsej	13,123	432	29	1,441	125	29	1,402	3,122	414	1,237	904	125	215	1,365	834	18	151	331	237	712

Fig. 1: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara sipas muajve

Fig. 2: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara sipas viteve



4 Ndërmarrjet sipas seksioneve ekonomike, formës legale të organizimit dhe kategorisë së numrit të punësuarve

Tab. 2: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike, tipit dhe kategorisë së numrit të punësuarve në Dhjetor 2025

Seksionet e veprimtarive ekonomike		Total	Kategoria e numrit të punësuarve									
			biznese individuale					biznese Jo-individuale				
			Gjithsej	0-9	10-49	50-249	250+	Gjithsej	0-9	10-49	50-249	250+
Gjithsej		1,000	221	220	1	-	-	779	768	11	-	-
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	20	3	3	-	-	-	17	17	-	-	-
B	Xehetari dhe gurëthyes	2	-	-	-	-	-	2	2	-	-	-
C	Prodhim	99	16	16	-	-	-	83	82	1	-	-
D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	8	-	-	-	-	-	8	8	-	-	-
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	2	1	1	-	-	-	1	1	-	-	-
F	Ndërtimtari	88	11	11	-	-	-	77	76	1	-	-
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	252	55	55	-	-	-	197	193	4	-	-
H	Transport dhe ruajtje	27	4	4	-	-	-	23	23	-	-	-
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim..	110	38	38	-	-	-	72	68	4	-	-
J	Informacion dhe komunikim	96	17	17	-	-	-	79	79	-	-	-
K	Aktivitete financiare dhe sigurimit	7	2	2	-	-	-	5	5	-	-	-
L	Aktivitete të patundshmërisë	22	1	1	-	-	-	21	21	-	-	-
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	120	25	25	-	-	-	95	95	-	-	-
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	58	8	7	1	-	-	50	49	1	-	-
O	Administratë publike dhe mbrojtje	1	-	-	-	-	-	1	1	-	-	-
P	Arsim	8	2	2	-	-	-	6	6	-	-	-
Q	Shëndetësi njerëzor dhe aktivitete të punës sociale	15	3	3	-	-	-	12	12	-	-	-
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	12	3	3	-	-	-	9	9	-	-	-
S	Aktivitete të shërbimeve tjera	53	32	32	-	-	-	21	21	-	-	-


Fig. 3: Ndërmarrjet e regjistruara sipas seksioneve ekonomike në Dhjetor 2025, krahasuar me të vitit paraprak**Tab 3. Numri i ndërmarrjeve sipas madhësisë për Dhjetor 2025**

Klasifikimi	Numri i të punësuarve	Numri i Bizneseve	%
Mikro ndërmarrje	0 - 9	988	98.8%
Ndërmarrje të Vogla	10 - 49	12	1.2%
Ndërmarrje të Mesme	50 - 249	-	0.0%
Ndërmarrje të Mëdha	250 e mbi	-	0.0%
Gjithsej		1,000	100%

Fig. 4: Struktura e ndërmarrjeve sipas madhësisë për Dhjetor 2025

Tab. 4: Struktura e ndërmarrjeve sipas gjinisë së pronarëve për Dhjetor 2025

Struktura e ndërmarrjeve të regjistruara sipas gjinisë së pronarëve						
Gjithsej	Ndërmarrje me pronarë meshkuj		Ndërmarrje me pronarë femra		Ndërmarrje me pronarë të përzier (meshkuj dhe femra)	
1,000	700	70.0%	245	24.5%	55	5.5%

Fig. 5: Paraqitja grafike e ndërmarrjeve sipas gjinisë së pronarëve për Dhjetor 2025


5 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas regjioneve

Tab. 5: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas regjioneve dhe seksioneve të aktiviteteve ekonomike në Dhjetor 2025

Regjionet		Gjithsej	Bujqësi, pylltari dhe peshkataria	Xehetari dhe gurëthyes	Prodhim	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	Furnizim me ujë, kanalizim, me naxhim mbeturinash	Ndërtimtari	Tregtimi shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike, motoçikleta ve	Transport dhe ruajtje	Akomodim dhe aktivitete të shërbi meve me ushqim	Informacion dhe komunikim	Aktivitetet financiare dhe sigurimit	Aktivitetet patundshëm
Kodi dhe emertimi		Gjithsej	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L
		1,143	42	1	110	18	2	132	268	46	105	77	13	19
RKS 001	Prishtinë	555	10	1	43	14	-	49	117	33	44	55	10	12
RKS 002	Mitrovicë	107	7	-	9	-	-	7	31	3	20	4	1	1
RKS 003	Pejë	92	12	-	10	2	-	14	22	1	6	3	2	-
RKS 004	Prizren	117	6	-	18	2	1	16	33	-	13	5	-	-
RKS 005	Ferizaj	114	3	-	17	-	-	15	30	4	9	4	-	3
RKS 006	Gjilan	82	2	-	7	-	-	12	18	3	7	4	-	3
RKS 007	Gjakovë	76	2	-	6	-	1	19	17	2	6	2	-	-

Regjionet	Gjithsej	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S
Kodi dhe emertimi	Gjithsej	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S
	1,000	20	2	99	8	2	88	252	27	110	96	7	22	120	58	1	8	15	12	53
RKS 001 Prishtinë	500	8	1	45	6	-	41	114	9	44	67	1	18	70	34	1	6	7	7	21
RKS 002 Mitrovicë	85	-	-	9	1	-	10	18	2	19	6	-	-	5	5	-	-	1	2	7
RKS 003 Pejë	59	2	-	6	-	-	9	13	1	6	6	1	1	7	2	-	-	1	1	3
RKS 004 Prizren	105	2	-	11	-	-	8	37	5	10	6	2	2	11	5	-	1	1	-	4
RKS 005 Ferizaj	87	3	-	13	-	-	8	28	4	11	2	-	-	6	3	-	1	2	-	6
RKS 006 Gjiilan	99	4	-	8	1	1	4	23	4	11	9	2	1	16	9	-	-	3	2	1
RKS 007 Gjakovë	65	1	1	7	-	1	8	19	2	9	-	1	-	5	-	-	-	-	-	11

Fig. 6: Struktura e ndërmarrjeve të regjistruara sipas regjioneve në Dhjetor 2025




6 Ndërmarrjet e regjistruara sipas formës legale

Tab. 6: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike dhe formës legale të organizimit në Dhjetor 2025

Seksionet e veprimtarive ekonomike		FORMA LEGALE E ORGANIZIMIT										
		Gjithsej	Biznes individual	Ortakëria e përgjithshme	Ortakëri e kufizuar	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	Shoqëri aksionare	Kompani e huaj	Ndërmarrje shoqërore	Ndërmarrje publike	Kooperativa Bujqësore	Zyra e Përfaqësisë në Kosovë
Gjithsej		1,000	221	-	-	774	-	4	-	-	-	1
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	20	3	-	-	17	-	-	-	-	-	-
B	Xehetari dhe gurëthyes	2	-	-	-	2	-	-	-	-	-	-
C	Prodhim	99	16	-	-	83	-	-	-	-	-	-
D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	8	-	-	-	8	-	-	-	-	-	-
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	2	1	-	-	1	-	-	-	-	-	-
F	Ndërtimtari	88	11	-	-	77	-	-	-	-	-	-
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	252	55	-	-	197	-	-	-	-	-	-
H	Transport dhe ruajtje	27	4	-	-	22	-	1	-	-	-	-
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	110	38	-	-	72	-	-	-	-	-	-
J	Informacion dhe komunikim	96	17	-	-	77	-	2	-	-	-	-
K	Aktivitete financiare dhe sigurimit	7	2	-	-	5	-	-	-	-	-	-
L	Aktivitete të patundshmërisë	22	1	-	-	21	-	-	-	-	-	-
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	120	25	-	-	93	-	1	-	-	-	1
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	58	8	-	-	50	-	-	-	-	-	-
O	Administratë publike dhe mbrojtje	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-
P	Arsim	8	2	-	-	6	-	-	-	-	-	-
Q	Shëndetësi njerëzor dhe aktivitete të punës sociale	15	3	-	-	12	-	-	-	-	-	-
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	12	3	-	-	9	-	-	-	-	-	-
S	Aktivitete të shërbimeve tjera	53	32	-	-	21	-	-	-	-	-	-

Fig. 7: Ndërmarrjet e regjistruara sipas formës legale të organizimit në Dhjetor 2025



7 Ndërmarrjet e shuara

Tab. 7: Numri i ndërmarrjeve të shuara sipas regjioneve dhe seksioneve të aktiviteteve ekonomike në Dhjetor 2025

Komunat		Gjithsej	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	Xehetari dhe gurëthyes	Prodhim	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	Ndërtimtari	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	Transport dhe ruajtje	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	Informacion dhe komunikim	Aktivitete financiare dhe sigurimit	Aktivitete të patundshmërisë	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social I detyrueshëm	Arsim	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	Art, zbavitje dhe rekreacion	Aktivitete të shërbimeve tjera
Kodi dhe emertimi		Gjithsej	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S
		135	8	-	14	-	-	15	41	6	18	1	1	1	13	4	-	1	4	-	8
RKS 001	Prishtinë	41	1	-	4	-	-	5	9	1	4	1	1	1	9	2	-	-	-	-	3
RKS 002	Mitrovicë	29	2	-	4	-	-	2	8	1	6	-	-	-	2	-	-	1	1	-	2
RKS 003	Pejë	11	2	-	1	-	-	2	4	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1
RKS 004	Prizren	16	2	-	1	-	-	1	5	1	4	-	-	-	-	1	-	-	1	-	-
RKS 005	Ferizaj	9	1	-	2	-	-	1	2	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
RKS 006	Gjilan	20	-	-	1	-	-	2	11	2	2	-	-	-	-	-	-	-	1	-	1
RKS 007	Gjakovë	9	-	-	1	-	-	2	2	-	1	-	-	-	1	1	-	-	1	-	-

- **Adresa:** AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.